



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:112046
Datë: 04.06.2024
Numri i dokumentit: 05776868

C.nr.837/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të paditëses: A.I nga M..., të cilën e përfaqëson Leutrim Ademi av në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës DKA- Mitrovicë, Baza e kontestit; Kompensim i shpërblimit jubilar, jashtë seancës gjyqësore me dt. 04.06.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSIDEROHET se është tërhequr padia e paditëses: A.I nga M..., të cilën e përfaqëson Leutrim Ademi av në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës DKA- Mitrovicë, Baza e kontestit; Kompensim i shpërblimit jubilar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja ka ushtruar padi me dt.01.06.2022, kundër të paditurës, për kompensim të shpërblimit jubilar.

Me aktvendimin e dt. 19.04.2024, paditësja është obliguar që brenda afatit 3 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit ta precizojnë kërkesëpadinë, me paralajmërimin se nëse paditësja brenda afati, gjykata do të konsideroj se paditësit e kanë tërhequr padinë, në kuptim të dispozitave të nenit 99 dhe 102 të LPK-së, të cilin vendim i autorizuari i paditëses e ka pranuar me dt. 25.04.2024.

Meqenëse pala paditësit brenda afatit ligjor të caktuar nga gjykata nuk e ka plotësuar dhe përmirësuar padinë e lartshënuar, në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, gjykata padinë e paditëses, kundër të paditurës, për kompensim të shpërblimit jubilar, e konsideron të tërhequr.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
C.nr 837/2022 dt.04.06.2024

Gj y q t a r i.
Blerim Istrefi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.